



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	05.01.2018
REFERENCË	
PËR:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan
CC:	z. Fauz Xhemajli, Nënkyetar i Komunës në Lipjan
NGA:	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan
LËNDA:	Raport i punës - Muaji Dhjetor 01.12.2017-31.12.2017

Gjatë muajit dhjetor DKA ka realizuar punë dhe aktivitete të ndryshme:

Më datë **29.12.2017** ka përfunduar gjysëmvetori i parë për vitin shkollor **2017/18** për nxënësit e ciklit **1-9** dhe **10-12**.

Planifikimi dhe përgatitja teknike e koordinatorit të kurrikulës në nivel komune dhe trajnerëve, për fillimin e vlerësimit të dosjeve të mësimdhënësve parafillor, klasa e parë, klasa e gjashtë dhe klasa e dhjetë, të cilët kanë filluar me zbatimin e kurrikulës nga shtatori.

Ekipi për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veqanta ka mbajtur takime dhe ka bërë vlerësimin e nxënësve, konform kërkesave të dorëzuara në DKA.

Me kërkesën e palëve është siguruar transporti për dy nxënës me nevoja të veqanta në relacionin Bregu i Zi-Lipjan dhe Banullë-Lipjan.

Furnizimi i Çerdhës me inventar.

Furnizimi me antifriz për nxemje qendrore për disa shkolla.

Instalimi i rrjetit të internetit në Shfmu Shkolla e re në Glllogvc.

Rregullimi-servisimi i nxemjes qendrore në:

- Shfmu “Haradin Bajrami” në Magure
- Shfmu “Ismail Luma” në Lipjan dhe
- SHMP “Adem Gllavica” në Lipjan

Përgatitja e raportit të punës për vitin **2017** dhe planit të punës për vitin **2018**.

Përgatitja dhe dorëzimi i raportit për planin e integruar për punët që DKA ka realizuar për periudhën **Korrik - Dhjetor 2017**.

Futja e buxhetit në programin qeveritar BDMS.

Përfundimi i shpenzimeve në kategorinë kapitale, mallra&shërbime dhe komunali.

Nënalokimi i mjeteve në kategorinë paga.

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe ate:

- Formular për ndryshime – kthim nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim – skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë,

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.